

POLITIKA MBI PAANSHMËRINË

DAK-PO-10

MIRATUAR NGA,
DREJTORE E PËRGJITHSHME
Gentiana ISLAMAJ

PËRMBAJTJA

1. FUSHA	3
2. REFERENCAT	3
3. PËRGJEGJËSITË	3
4. FJALORI DHE SHKURTESAT.....	3
4.1 Fjalori	3
4.2 Shkurtesat	3
5. PËRSHKRIMI I POLITIKËS	3
6. ANEKSET	4
7. REGJISTRAT	4
8. HISTORIA	5

1. FUSHA

Ky dokument përshkruan Politikën mbi Paanshmërinë të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit të Kosovës (DAK).

2. REFERENCAT

- a) Ligji nr. 05/L-117 për Akreditimin
- b) ISO/IEC 17011:2017 Vlerësimi i Konformitetit – Kërkesat për trupat e akreditimit që akreditojnë trupat për vlerësim të konformitetit;

3. PËRGJEGJËSITË

Kjo vlen për stafin e brendshëm dhe të jashtëm të DAK të përfshirë në akreditim (siç janë stafi i brendshëm i DAK-së, KP, KA, KT-të, vlerësuesit dhe ekspertët) dhe për klientët e DAK-së (të akredituar dhe që kërkojnë akreditim).

4. FJALORI DHE SHKURTESAT

4.1 Fjalori

Për qëllimet e kësaj politike zbatohen termat dhe përkufizimet e dhëna në standardin ISO/IEC 17011:2017.

4.2 Shkurtesat

KA	Këshilli i Akreditimit
TVK	Trupi për Vlerësimin e Konformitetit
DAK	Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit të Kosovës
EA	European Accreditation (Bashkëpunimi Evropian për Akreditim)
ILAC	International Laboratory Accreditation Council (Këshilli Ndërkombëtar i Laboratorëve të Akreditimit)
KP	Këshilli Profesional
KT	Komitetet Teknike

5. PËRSHKRIMI I POLITIKËS

DAK është trupi i vetëm kombëtar i akreditimit të Kosovës për akreditimin e trupave për vlerësim të konformitetit, i rregulluar me Ligjin nr. 05/L-117 për Akreditimin. DAK operon në përputhje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17011:2017 dhe Rregulloren (KE) nr. 765/2008.

DAK është e përkushtuar dhe përgjegjëse për realizimin e të gjitha aktiviteteve të akreditimit në një mënyrë të paanshme dhe objektive. DAK është një organ qeveritar nën përgjegjësinë e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

DAK nuk ka pronësi aksionare, komerciale ose interes tjetër në ndonjë TVK, dhe ofron shërbimet e akreditimit në baza jo-fitimprurëse. DAK nuk ofron vet ndonjë aktivitet të vlerësimit të konformitetit që mund të jetë objekt i akreditimit. Të gjitha aktivitetet e akreditimit të DAK-së administrohen në një mënyrë jodiskriminuese dhe janë të hapura për të gjithë aplikantët që plotësojnë kriteret e zbatueshme.

Pajtueshmëria me kërkesat e paanësisë garantohej edhe nga KP i DAK-së, i krijuar sipas Udhëzimit Administrativ (MTI) nr. 02/2018, i cili siguron përfaqësimin e balancuar të palëve të interesuara në operimin e tij.

DAK është i strukturuar në një mënyrë të tillë që ruan paanshmërinë në të gjitha nivelet e operimit. Personeli i DAK-së (i brendshëm dhe i jashtëm) dhe anëtarët e KP, KA dhe KT kërkohet të veprojnë në mënyrë objektive dhe të jenë të lirë nga çfarëdo presioni i padrejtë komercial, financiar dhe të tjera që mund të rrezikojnë paanshmërinë. Atyre u kërkohet të deklarojnë, pa vonesë, çfarëdo konflikti të mundshëm interesi kurdo që mund të shfaqet.

DP, me përfshirjen e KP, vendos për masat e nevojshme për të eliminuar ose minimizuar rrezikun ndaj paanshmërisë, si dhe të dokumentojë rrezikun e mbetur. Procesi i menaxhimit të rrezikut të DAK-së (DAK-PO-09) siguron që rreziku i mbetur të rishikohet dhe përcaktohet nëse është brenda nivelit të rrezikut të pranueshëm. Kur identifikohet rreziku i pranueshëm ndaj paanshmërisë dhe i cili nuk mund të ulet në një nivel të pranueshëm, atëherë DAK nuk ofron akreditim.

DAK nuk ofron shërbime këshillimi. DAK ofron trajnime vetëm për informacione gjenerike, që janë në dispozicion të lirë në domenin publik. Qëllimi i kurseve të trajnimit të DAK-së për stafin e tij, për vlerësuesit/ekspertët, KP, KA dhe KT është që të harmonizojnë aktivitetet e akreditimit, veçanërisht proceset e vlerësimit, si dhe t'i bëjnë ato efektive.

Në lidhje me TVK-të që i përkasin Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (trupat e lidhur), DAK nuk cakton asnjë anëtar të KA në procesin e vendimmarrjes, nëse vetë ose organizata e tij/saj ka ndonjë lidhje me MTI ose TVK-të të lidhura me MTI.

DAK vlerëson kërcënimet e mundshme ndaj paanshmërisë në rast dyshimesh, por të paktën çdo vit përmes auditimit të brendshëm dhe procesit të menaxhimit të rrezikut. Rezultati i vlerësimit diskutohet në KP.

6. ANEKSET

Nuk aplikohet

7. REGJISTRAT

Nuk aplikohet

8. HISTORIA

Data e botimit	Përgatitur nga	Përshkrimi i ndryshimeve të zbatuara
16.05.2019	Ardiana Krrabaj	Dokument i ri
15.11.2019	Valmira Sejdiu	Rishikim i plotë në përputhje me ISO/IEC 17011:2017 dhe DAK-PM-01